

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 536 .Prot.

Rrogozhinë, më 03.02.2026

NJOFTIM

Konsultim publik për projektvendimin “Për miratimin e kalimit në përdorim të një prone në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë në favor të Shoqërisë KF Egnatia SH.A”

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë Z. Edison Memolla.

Qëllimi: Ky bashkëbisedim me banorët dhe grupet e synuara të Bashkisë Rrogozhinë ka për qëllim mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me kalimin në përdorim të një prone në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë në favor të Shoqërisë KF Egnatia SH.A, në Njësinë Administrative Lekaj.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në Njësinë Administrative Lekaj, sipas kalendarit si më poshtë:

Data: 17.02.2026

Ora: 13:00

Vendi: Njësia Administrative Lekaj

Gjithashtu, sugjerimet janë të mirëpritura, në adresën e emailit visi.shera85@gmail.com

Linku i dokumentit: <https://bashkiarrogozhine.gov.al/>


Pjesëmarrës:

- Nga ana e Bashkisë: Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, administrata e bashkisë.
- Nga komuniteti: Banorët e Bashkisë Rrogozhinë, Njesisë Administrative Lekaj, organizata joqeveritare dhe shoqëri civile.

Forma e konsultimit: Takim publik.

Qëllimi i këshillimit publik

Diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve sa i takon projektvendimit “Për miratimin e kalimit në përdorim të një prone në pronësi të Bashkisë Rrogozhinë në favor të Shoqërisë KF Egnatia SH.A”.



Përshkrimi i çështjes

Aktualisht prona është pa funksion përdorimi e cila nuk gjeneron të ardhura për bashkinë Rrogozhinë, me të drejta të plota si pronare e saj. Për ta vendosur atë në efikasitet, bashkia Rrogozhinë, propozon dhënien në përdorim të saj nga shoqëria KF Egnatia, e cila do të jetë përgjegjëse për mirëfunksionimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pronës. Propozohet nga ana e bashkisë Rrogozhinë që kjo pronë do të kalohet vetëm për përdorim, pa kalim të drejtash të pronësisë tek KF Egnatia, me një afat të përcaktuar prej 25 vitesh me të drejtë rinovimi. Duke qenë se bashkia është pronare me 25% tek KF Egnatia dhe detyrimet për investim apo vendosje kapitali lindin nga kjo bashkëpronësi, propozon që vendosja e kësaj prone me kushtet e sipërpërmendura tek KF Egnatia, bën të mundur uljen e vendosjes së kapitalit financiar drejt për së drejti, duke i mundësuar ato në kapital në natyrë.

Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;

Komentet dhe rekomandimet tuaja mund të jepen në adresën e emailit:


visi.shera85@gmail.com

Ato mund të dorëzohen me postë ose fizikisht drejtuar Bashkisë Rrogozhinë ose në zyrat e Njesisë Administrative Lekaj, brenda datës **17.02.2026**.

Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerren Këshilli dhe administrata për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit

Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:

1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;
2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Financës, komisionit të Urbanistikës, Zhvillimit Ekonomik dhe Infrastrukturës Urban dhe si dhe çdo këshilltari të



bashkisë;

3. Shqyrtimi nga ana e komisioneve të mësipërme të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;

4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në paketën e maleve.

5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit;

6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;

7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar;

8. Monitorimi i zbatimit të tij.

Data e publikimit

03.02.2026

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KESHILLIT
MUKADES GIXHARI

